



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV
Sesioni pranveror

Mbledhja plenare e Kuvendit
P- 55
Prishtinë, më 12 prill 2012

P R O C E S V E R B A L

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, TË
MBAJTUR MË 12 PRILL 2012**

Mbledhjen e drejtoi **Jakup Krasniqi**, kryetar i Kuvendit.

Kryetari deklaroi të hapur punimet e mbledhjes plenare dhe konstatoi se në sallë janë të pranishëm 75 deputetë.

Në fillim të mbledhjes, deputetët e lëvizjes “Vetëvendosje” – Glauk Konjufca dhe Visar Ymeri dolën para foltores, duke mbajtur në duar një pano, në të cilën ishin shënuar emrat e Enver Zymberit – zyrtar i Policisë së Kosovës, i vrarë nga strukturat kriminale serbe, më 26 korrik 2011 dhe i Selver Hradinajt – i vrarë nga shpërthimi i eksplozivit në banesën e tij, në lagjen “Tre rrokaqiejt” në Mitrovicë, më 8 prill 2012.

Pas disa minutave, kryetari i Kuvendit kërkoi nga dy deputetët e lëvizjes “Vetëvendosje”, që mbanin panon, të tërhiqen nga bina e sallës në mënyrë që Kuvendi t’i zhvillojë punimet sipas agjendës së paraparë.

Më pas kryetari caktoi një pauzë dhe ftoi kryetarët e grupeve parlamentare dhe anëtarët e Kryesisë së Kuvendit në një konsultim të përbashkët.

Pas takimit konsultues, kryetari kërkoi edhe një herë nga deputetët Glauk Konjufca dhe Visar Ymeri që t’i zënë vendet e tyre, në mënyrë që Kuvendi të fillojë me punë, por dy deputetët e lëvizjes “Vetëvendosje vazhdonin ta mbanin panon para binës së sallës.

Më pas, kryetari iu referua nenit 42 dhe 49 të Rregullores së Kuvendit që kanë të bëjnë me përcaktimin e rendit të ditës të mbledhjes plenare dhe shqyrtimin e çështjeve urgjente në Kuvend.

Në vazhdim, për fjalë u paraqit deputeti Ismet Beqiri.

Ismet Beqiri, në emër të GP të LDK-së, kërkoi që pika e 4-të e rendit të ditës së mbledhjes së sotme - shqyrtimi i dytë i Projektligjit për bankat, institucionet mikrofinanciare dhe institucionet financiare jobankare, të hiqet nga rendi i ditës.

Në vazhdim kryetari kërkoi prononcimet e kryetarëve të grupeve parlamentare.

Adem Grabovci, në emër të GP të PDK-së, tha se këtë pikë të rendit të ditës ka kërkuar ta heq nga mbledhja plenare e kaluar, në mënyrë që pas konsultave me Fondin Monetar Ndërkombëtar të procedohet në mbledhjen e radhës. Konsultat me Fondin Monetar Ndërkombëtarë i kemi bërë, theksoi ai.

Liburn Aliu, në emër të lëvizjes “Vetëvendosje”, në diskutimin e tij u fokusua në nevojën e mbajtjes së një mbledhje të jashtëzakonshme të Kuvendit, pas vrasjes së Selver Haradinajt dhe plagosjes së familjarëve të tij dhe demolimit të pikës statike të policisë së Kosovës, në Mitrovicë.

Kryetari theksoi se ne jemi duke ndërtuar shtet dhe akte të tilla çfarë po paraqiten sot nga deputetë të lëvizjes “Vetëvendosje”, në Kuvend, nuk na duhen.

Institucionet shtetërore i kanë të përcaktuara me Kushtetutë detyrat dhe përgjegjësitë e tyre. Kuvendi mbledhet në mbledhje të jashtëzakonshme nëse këtë e kërkon Presidenti, Kryeministri dhe me nënshkrimet e 40 deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës, sqaroi ai. Rregullorja e Kuvendit duhet respektohet nga të gjithë.

Ismet Beqiri, në emër të GP të LDK-së, lidhur me mundësinë e mbajtjes së mbledhje të jashtëzakonshme të Kuvendit, theksoi se grupi që ai përfaqëson përkrahin mbajtjen e saj, por vetëm pasi të kthehet kryeministri i vendit nga vizita zyrtare, në mënyrë që ai dhe kabineti qeveritar të jenë të pranishëm në Kuvend.

Adem Grabovci, në emër të GP të PDK-së, tha se situata në veri të vendit duhet të jetë preokupim i përbashkët i të gjitha institucioneve dhe forcave politike dhe jo vetëm i Qeverisë së Kosovës.

Në lidhje me mbajtjen e mbledhjes së jashtëzakonshme të Kuvendit, theksoi se grupi që ai përfaqëson, nuk pranon asnjë imponim jashtë Rregullores së Kuvendit.

Ardian Gjini, në emër të GP të AAK-së, tha se dje në mbledhjen e Kryesisë me kryetarët e grupeve parlamentare ishim pajtuar për mbajtjen e mbledhjes së sotme plenare, ndërsa pas atmosferës së krijuar në mbledhjen e sotme, ai propozoi që ajo t’i ndërpresë punimet dhe të vazhdojë ndonjë ditë tjetër.

Myzejene Selmani, në emër të GP të Koalicionit Kosova e Re, tha se skenat e tilla në Kuvend nuk na takojnë neve si deputetë të Kuvendit.

Në lidhje me mbajtjen e mbledhjes së jashtëzakonshme të Kuvendit, tha se kjo duhet bërë vetëm në prezencë të kryeministrit të vendit dhe të gjithë kabinetit qeveritar.

Sasha Milosavljeviq, në emër të GP SLS, tha se nuk mund të pranojnë asgjë që paraqet shkelje të Rregullores së Kuvendit.

Albert Kinolli, në emër të GP "6+", tha se jemi për vazhdimin e mbledhjes plenare sipas agjendës së paraparë, ndërsa për mbledhjen e jashtëzakonshme e Kuvendit, të procedohet sipas Rregullores së Kuvendit.

Deputeti **Agim Kuleta** propozoi që lidhur me situatën e krijuar në veri të vendit, sot Kuvendi të nxjerrë një deklaratë, ndërsa mbledhja e jashtëzakonshme e Kuvendit të mbahet nesër me prezencë të kryeministrit.

Në vazhdim, kryetari kërkoi edhe një herë nga deputetët Glauk Konjufca dhe Visar Ymeri që t'i zënë vendet e tyre, në mënyrë që Kuvendi të mund t'i zhvillojë punimet sipas agjendës së paraparë.

Më pas, kryetari caktoi një pauzë 10 minutëshe dhe ftoi nënkryetarët e Kuvendit në një takim konsultativ.

Diskutimet e plota të kryetarit të Kuvendit dhe të deputetëve të lartpërmendur janë dhënë në transkript.

Në vazhdim të mbledhjes plenare deputeti **Adem Grabovci** kërkoi që ndaj deputetit Glauk Konjufca dhe Visar Ymeri të mos përdoret forca.

Ai propozoi që nga rendi i ditës së mbledhjes së sotme të hiqen, pika nr.1- Koha për deklaramë jashtë rendit të ditës dhe pika nr. 2- Koha për pyetje parlamentare.

Më pas, kryetari hodhi në votim propozimin e **Ismet Beqirit**, kryetar i GP të LDK-së, që pika nr. 4. e rendit të ditës së mbledhjes së sotme - shqyrtimi i dytë i Projektligjit për bankat, institucionet mikrofinanciare dhe institucionet financiare jobankare, të hiqet nga rendi i ditës.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 30,
Kundër----- 50,
Abstenime----- 0.

Kryetari konstatoi se Kuvendi nuk miratoi propozimin e kryetarit të GP të LDK-së që nga rendi i ditës të hiqet pika e 4 - shqyrtimi i dytë i Projektligjit për bankat, institucionet mikrofinanciare dhe institucionet financiare jobankare.

Pastaj, kryetari hodhi në votim propozimin e **Adem Grabovcit**, kryetar i GP të PDK-së, që nga rendi i ditës së mbledhjes së sotme të hiqen, pika e parë dhe e dytë, ndërsa seanca t'i vazhdojë punimet me vetëm dy pika: 1 Miratimi i procesverbalit dhe 2. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për bankat, institucionet mikrofinanciare dhe institucionet financiare jobankare.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 53,
Kundër----- 27,
Abstenime----- 3.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, vendosi që Kuvendi t'i vazhdojë punimet me këtë

R e n d d i t e:

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mëparshme,
2. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për bankat, institucionet mikrofinaciare dhe institucionet financiare jobankare.

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes plenare të mbajtur më 29, 30 mars dhe 5 e 6 prill 2012

Kuvendi, miratoi pa asnjë vërejtje procesverbalin e mbledhjes plenare të datës 29, 30 mars dhe 5, 6 prill 2012.

Pas kësaj pike, deputetët e grupeve parlamentare të LDK-së, të AAK-së dhe të lëvizjes “Vetëvendosje” lëshuan sallën.

Kryetari konstatoi se në sallë janë të pranishëm 62 deputetë dhe Kuvendi mund t'i vazhdojë punimet.

2. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për bankat, institucionet mikrofinaciare dhe institucionet financiare jobankare

Kryetari i njoftoi deputetët për raportet dhe rekomandimet e komisioneve të përhershme dhe të Komisionit funksional raportues për Projektligjin për bankat, institucionet mikrofinaciare dhe institucionet financiare jobankare.

Raportin e Komisionit funksional për Buxhet dhe Financa, për Projektligjin për bankat, institucionet mikrofinaciare dhe institucionet financiare jobankare e arsyetoi kryetarja e këtij komisioni, Safete Hadergjonaj.

Kryetari hodhi në votim amendamentet veç e veç.

Kuvendi miratoi këto amendamente: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17, 18, 19, 20, 21, 22, 23, 24, 25, 26, 27, 28, 29, 30, 31, 32, 33, 34, 35, 36, 37, 38, 39, 40, 41, 42, 43, 44, 45, 46, 47, 48, 49, 50, 51, 52, 53, 54, 55, 56, 57, 58, 59 - i plotësuar, sipas diskutimit të deputetes Safete Hadergjonaj; 60, 61, 62, 63, 64 dhe amendamentin nr. 65 - i plotësuar, sipas diskutimit të deputetes Safete Hadergjonaj.

Për amendamentet e propozuara diskutuan deputetët: Muhamet Mustafa, Fatmir Xhelili dhe Safete Hadergjonaj, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pastaj, kryetari hodhi në votim Projektligjin me amendamentet e miratuara, në tërësi.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 55,
Kundër----- 0,
Abstenime----- 4.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, miratoi Ligjin për bankat, institucionet mikrofinaciare dhe institucionet financiare jobankare.

Kryetari konstatoi të mbyllur punimet e mbledhjes së sotme, në orën 13:25 minuta.

Kryetari i Kuvendit

Jakup KRASNIQI

Përgatiti: Divizioni për Çështje Plenare dhe Procedurale